

83H-1-2

S 22

PETRAQ S. SAMSURI

FLETE RRUFE



Sikur tish
rrufe nga setë

VJERSHA SATIRIKE

891.983-1-2

522

PETRAQ S. SAMSURI

S

Sikur t'ish rrufe nga retë

(VJERSHA SATIRIKE)

20613


~~H.20613~~

BIBLIOTEKA e Shkollës
Gjinocombanit

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

ME NJË SHOK TË DELEGUAR

Erdh në fshat i deleguar
Për kontroll edhe me punë,
Takoi njerzit kryesorë,
Ca i fshehnë e ca s'ia thanë
Dhe, siç thotë shprehj' e gjallë,
«Kaloj me kallaj mbi gunë»



Shoku shok, i deleguar,
Ulu shesh e shtrohu mirë!
Përshëndetu me fshatarët,
Rrëmo thellë e rri më çlirë,
Se nga goja e atyre,
Që prodhojnë çdo të mirë,
Mund të mbledhësh xhevahirë!

SA TË VIJË PRAP KONTROLI

Kur vjen kontroll nga Tirana,
S'ke ç'i thua ofiqarit.
E prët popllin urtë e butë,
Na punon e jashtë orarit...



Kur ekipi le shëndenë,
S'ka buzqeshje, s'pyet «ç'doni?»
Lipsur qoftë puna me popull,
Nis të ngrihet tensioni.

E fillon me gjuhë të ashpër,
Shit e bot burokraci,
Eshtë i lodhur, ka dhe mbledhje...
N'orë pritje s'hyn njeri.

Dikush s'priti, çeli derën
Po nga ç'hyri më parë dolli
— Prit me ne — i tha një tjetër —
Sa të vijë prap kontrolli..!

PUNË E NXITUAR

Nga qyteti shkoi në fshat
Një estradë, pak nxituar,
I heq pjesës njërin akt,
Se programi do shkurtuar...

Edhe pjesë e sakatosur
Shkoi ashtu si shkoi,
Sa fshatarët thanë nga fundi,
«Shyqyr, që mbaroi»!

Se s'ka pjesa kok' e bisht,
As përbajtje as ide,
Veç diçka qe shumë e qartë:
Ishte plani për atje.

Më ngadalë, shoqe estradë,
Dosido nuk të del loja,
Ja që fshati s'është i djeshmi,
U ruaj se të del boja!

KONTRASTE MIQSH

(Qytetar i deleguar në fshat)

— Mirsejugjej, o miq bujarë!
Gjithnjë ju ardhsha për gëzime,
Portë e juaj gjithmonë hapur,
Jam ashtu si në sht'pi time!

(Qytetari në qytet)

— Kur ke ardhur, kur do ikësh?
Diku jemi parë tok...
S'më vjen në hatër. E po më fal,
Se më pret aty një shok.. !

NA DEL SHKRIM ORIGJINAL

Kur na mblidhet kolegjumi
i estradës të shqyrtojë
shkrime nga bashkëpuntorët,
i ka zët t'i aprovojë.

Thonë shkrimi është i gjatë,
Shumë i vjetër ky problem,
Dhe kur është i përsosur,
Shpejt i ngjitet ndonjë cen...

Po, kur vjen sezoni ri,
Ky problem, që ish i vjetër,
Del e bëhet aktual,
Vëçse nga një firmë tjetër...

Se antar i kolegjumit
Bën punimin ideal:
I heq pikat, thonza, presje
dhe del shkrim origjinal...

Me të drejtë ju gjurmoni,
Fshikulloni çdo të metë,
S'është keq, më ndonjë numur,
Të goditeni dhe vetë.



I REGJURI

Kur dëgjon q'e kritikojnë,
Ndizet, nxehet, bëhet furre;
Veçse trimi është i regjur,
Kritikën e pret si burrë!

Dhe kur bën autokritikë,
(Sikur gadi po derdh lot)
Angazhohet për të ardhmen,
Thua, sot i vuri pikë.

Mbledhjen tjetër prap havazi;
Thotë: — Më thumboni kot,
Unë kritikën e pranoj,
Por... zotimet s'i mbaj dot.

Shok, vështrohu në pasqyrë!
Zgjohu, shkundu, pak nga pak;
Se kur vrëhet e shkreptin
E jep shënja anembanë,
Mblidhi rripat, veri gjoksin,
Vjen furtuna të përlan!

Kot më kot s'ka thënë plaku:
«Stomna, shkon, vjen e kthehet,
Por nganj' herë ngel te praku!»



FJALE TË MIRA E GUR'NË TRASTË

Priti, priti gjithë sa ishin
Urtë e butë e me durim,
Ikë një e hyr një tjetër,
Sikur të ishin për urim...

Hapej dera mbyllej dera,
Pritje e popullit t'i themi...
Javën tjetër prap havazi,
Se asnjejt s'ju zgjidh problemi.



Si nëpunës është në rregull
Dëgjon njerëzit u qan hallë,
Fjalë të mira gur' në trastë,
Sa problemet ecin zvarrë.

Hajde shko, e shko e kthe,
Iku viti e ca muaj
(Pasi hedh edhe ca shuaj)
Kësaj i thonë në gjuhë tonë:
Sit e sit e mos gatuaj.. !

NË AMBIENT

Ka mbaruar shkollë të lartë
Sjell të renë, ka kulturë,
Eshtë i kohës në ndërgjegje,
Mbeturina, s'pranon kurrë!

Vec fjalorë e vjetruar
Ndon s'e pati në provim,
Me të kthyer në ambient,
Shpejt e vu në përdorim.

«Ndjesë pastë» në ngushllime,
«Zoti dhëntë» në urime,
Dhe «amin» kur çfaq dëshirë,
«Do zoti» kur pret më mirë!

Kur di gjë, apo nuk di,
Shpejt bën be «Për perëndi»
Dhe «Adio» demek «te zoti»,
Shpesh e thotë si qëmoti!

Shkolla i ka bërë vënd,
Eshtë djalë parimor,
Këmbëkryq shtrohet te këndi
(Se kështu lidhet me masën)
Muhabet siç e do vëndi...!



«TRESHI KA GJITHË UNITET!»

Ishin ç'ishin në një zyrë,
Qe një kolektiv i zgjedhur,
Porsi tenxherja kapakun
Me qiri na ishin mbledhur!
Ish drejtori, deli burrë,

Shefi qe për plagë melhem
Gojémjaltë kontrollori,
Të tér' katërgind drehem!
Thotë, drejtori «propozohet»
Shpejt dhe shefi «aprovohet»,
Kontrollori, po... «pranohet».
Diku flet dhe ndonj' i vogël
Por i thonë, «mos u zgjat shumë...
Se po ve mbledhjen në gjumë!»
Dhe pastaj, diç thonë në vesh
Doemos ashtu si tresh!
Dhe kështu të gjithë «Amin»
S'ka pyetje, diskutim...
.....

Ç'ecin punët në ktë zyrë!
Në të keq e çdo siklet,
«Treshi» ka gjithë unitet... *29/6/13*

KUR VĒRSHON ZĒRI I MASĒS

Ka ndonjë, që i fryn pendët,
E kujton se fluturon,
Lëshon urdhëra, jep vendime,
Këmbanë e tij tingëllon...

Po kur vërshon zëri masës,
I ul puplat e s'flet më.
Edhe zëri del i ngjirur,
Dhe këmbana s'lëshon zë!

«NXEHJE SPORTIVE»

Shkova te një burokrat,
Ditn' e parë më tha «po»,
Ditën tjetër më tha «jo»,
Të pasnesërmen «të shoh».

Pas ca kohe më tha «prit»
Mbas një muaj «mos u mërzit».
Shkoi një vit, tha «kam harruar,
E dija punë të mbaruar...»

Por tani shtoi, ngadale,
«jam zënë një kohë të gjatë,
Me telashe familjare...»
— Mjaft — i thash' havazë e vjetër,
S'kam durim, për «sezon» tjetër...

Ti, më poqe e më nxive,
Kam një vit «nxehje sportive»!
Puna ime, unë e ti,
Do të hyjmë në histori..!

PARAGJYKIM

— Kur bën veshi ciu, ciu,
Vjen pa tjetër një re shiu.
Po lot syri më një anë,
Vjen e keqja, prit hatanë.
Kur del para dac i zi,
Kthe nga rruga në shtëpi.
E mos dilë as mos hyrë
Se do ngjasë ndonjë mënxyrë!

— Po të ndeshësh m'ish uratën,
Rrëmbe kazmën e lopatën.
Kur sheh ëndërr se shikon
Turli ëndrra natën vonë,
Del gëzim e del trishtim,
Del gjithmonë paragjykim...



BABA QERIMI ISH ZEMÉRUAR

...nga koha e shkuar

Baba Qerimi ish zeméruar.
Mblodhi besnikét anë e mbanë:
— U bënë të keq — u thoshte — njerzit
Do të vendos, të bënj hatanë.

— Sabër, aman! — thirrën besnikét,
Puth këmbë e dorë e thuaj medet, —
Axhetis kafshët, ç'faj kanë fëmijët? —
Baba mos bëj këtë qahmet.

Më keq dinaku thërret e cirret
— Çdo lutje kot — tha më në fund —
E kam vendosur e do ta bënj,
Do përmbyss botën ja... do ta tund.

— Bëje, or qen , — tha më i riu,
Tek po zjente. si vullkan, —
Në është bota në dorë tënde,
Përmbyse shpejt, mos prit «aman».

— Sus, mor lanet — foli babai —
Qofsh i mallkuar, ç'po flet kështunë,
Nuk bëj asgjë, se u penduash;
Do ti tani, po s'dua unë.

EDHE «ZOTI», S'QE I ZOTI

Kush vjedh a merr në vakëf
Patën thënë dikur që moti,
Sot a nesër, shpejt a vonë,
Do t'i marrë hakën «Zoti»...

Mirëpo shekuj e vjet vanë,
Prijs, shënjtörë e perandorë,
Vodhën, hëngrën sa mënd plasën,
«Zoti madh»... nuk vuri dorë!

Prandaj njerëzit sot dyshojnë,
Edhe kjo kuptohet lehtë:
Ose «Zoti» s'qe i zoti,
Ose qe ortak dhe vetë...!



SHKËNDIA E SHENJTË

Një kryq të madh na bëri tezja,
Ndezi kandilë mbushur me lyrë,
dy tre shënjtorve fytyrëngrysur
Zbetë u ndriti ajo fytyrë.

U ngroh ikona e pak nga pak
Shkëndia e shenjtë dha zjarr e flakë,
Dhe u hodh flaķa mori tavanë.
Luftoi me tē plaka e shkretë
Ndërsa shënjtorët, që u digjej mjkra,
Asnjë përpjekje nuķ bënин vetë.

Tronditet tezja e bën çudi
— Shyqyr tē qoftë moj perëndi...
Gjynah mos paça e mos u thëntë
Si ra ky zjarr në vend tē shenjtë?!

— Leri, moj nënë, i foli nusja —
Leri tē bëhen shkrumb edhe hi.
Kur s'janë tē zot tē mbrojnë veten
Ç'presim prej tyre unë e ti?
S'të ndihnë fare, leri mënjanë
Ndezën shtëpinë, gjetëm belanë!!



E KUPTOI DHE TETO MARA

Shteroi lop' e teto Maros
Iu bë gjiri kyç, u tha.
D'uall brinjët porsi rrathë,
Mbeti lopa për hata.

Rendi tetua, lau kryqin,
I vu lopës hajmali,
Dhe në bisht një pe të kuq,
E këndoi pastaj në gji.

Gratë i thanë marshalla!
Me ajazëm e spërkatit.
Mirpo lopa s'po lëshonte
Pikë qumshti «nga inati. . .»

— Të pëlcasë syri i lig,
Me zili ma paska parë,
Zhaba lopën ma ka pirë —,
Thirrë e bot, kjo teto Marë!
M'u tha lopa tha në fund,

I vu jonxhë, shtoi tagjinë,
Dalngadalë iu çqitën brinjët,
Plaka vu përposh kusinë...

Lopa s'paska marrë sysh,
Hajmalisë i doli boja,
E kuptoi teto Mara,
Lopa milet që nga goja...!

NUK I MBETET KOHË.

Burrë e grua ranë n'ujdi
Të ndajnë punët e shtëpisë
Të punojnë që të dy,
Secili sipas fuqisë
Por ashtu si brez pas brezi,
Burri prapë si këndezi:

— Grua, ti e merr pastrimin,
Bukë e gjellë dhe pazarin
Dhe ashtu si nënë e mirë,
Kujdes çupën edhe djalin,

— Ngadal burrë — i tha e shoqja
S'e fillove ndarjen mirë,
Ti mbetesh ngarkuar shumë,
S'do t'të mbetet kohë e lirë...

— Mos bërtit, moj e uruar
Se zgjove gjithë mëhallën,
Pse pak jam vetë i ngarkuar?
Kam komandën, urdhrin, fjalën!




SIKUR T'ISH RRUFE NGA RETË

Ish në gjëndje xha Klasëmi.
Por mendohej: e kish hakë
Vetë ishte shtatdhjetë vjet,
Por e kishte gruan plakë...

Xha Kasëmi ka të drejtë,
Doemos njeri i gjallë,
S'u bë hata për një femër,
Kur kto raste ndodhin rrallë...

«Edhe një...» — thosh xha Kasëmi
Lëshoi vlesë anembanë,
— Ç'ka rinia, ç'do me mua?
Ti ke vajzën un' paranë.

Por s'arriti dhëndri plak
Ta shijonte një të tretë,
Fletrrufeja e goditi
Sikur t'ish rrufe nga retë!



DIALOG I SHKURTUAR


Merre; bijë merre,
Merre mos fu ndaj,
Djalin e njoh unë,
Ta zgjodhi babaj...
— C'janë këto që thua?
Kujton se s'të dua?!

— Babë në më do,
Lere këtë punë
Kur zgjodhe mamanë,
A ndërhyra unë?

ESHTË PUNA IME

Êshtë epror i bir' i botës,
Ka flakur çdo gjë të metë.
Veç ka qejf shumë kopimentat.
Sidomos nga seksi tjetër...

Kur e krehin, i buzqeshin,
Përmbyt plane e vendime
Në guxofsh ta kritikosh
Ta pret shkurt; «Êshtë punë e ime»!



Barikadë vë pozitën,
Dhe kërkon të respektohet
Veç harron respekti s'jipet,
Por fitohet edhe mbrohet...

Ç'FAJ I KEMI?

Eshtë e hidhur, po, kritika
Jep të nxeh të e të sëmbon
Po me djersë del e keqja,
Nganjëherë të shpëton

Veç ki mëndjen, kur je shtrembër,
Ka disa që të lëmojnë,
Të lëvdojnë e pëshpërisin,
«Ç'faj i kemi, kur s'dëgjon...?»

SI-CFINGU

Kafshë e zogj na u peshuan
Fili dolli qindra okë
Ish m'i ri nga gjith të tjerët,
Por m'i rëndi në gjithë shokë

— Njëqind okë jam dhe vetë
Cfingu tha, duk' u lëvduar
Jam një mot m'i vjetër unë
Fili si ma ka kaluar?

— Hidhiu peshës — foli kau
Dhe zëmrohet i habitur
Ti me këmbët si fill kashte
Përmbi ne na qënke rritur?

— Po vërtet jam njëqind okë —
Thoshte cfingu — s'ka dyshim,
S'pranoj unë tjetër peshë
Unë kam kandarin tim...

— Shiko cfing, se je gabuar,
Do tē dalësh hileqar,
Thoshim kafshët duke qeshur
S'do ta kesh kandarë ajar...

• • • • • : : :
T'matesh me kandarin tënd,
S'është punë aspak me mënd...!

KËSAJ RADHE MË S'I ECI.

Raqeja, si qe martuar,
Mëbas dy vjet i plasi sheri,
I shkoi syri diku gjetkë,
E s'i pijej karakteri

— Mblidhu burrë — i thosh e shoqja,
Por ai gjithnjë të tijën.
Ik — i thoshte — shiko punën
Po t'i fal edhe fëmijën...
Merr të dytën shkojnë vjete
Raqja prap havazë e parë
S'je për mua — i thosh gruas —
Se ke nerva, je e marrë...
I vu drunë e së dytës.

Raqja shpejt e dha kararë
Për divors s'e pât vështirë
E kish gati majë gjuhës
Epitetin «s'qëndron mirë»

Dolli Raqja prap në pjacë
Nuk desh vles, isht' usta vetë
S'ka mbetur pa bisht laraskë
Shpejt e gjeti një të tretë.

Po ksaj radhe nuk i eci
Sepse njerzit e përbuzë
U gjend ngushtë para gjyqit
Kur i ngriten akt-akuzë.

Dëshmitarë e ankuës,
Qen' të bijtë edhe çupa
Dhe tri gra njera pas tjetrës
Se më s'ngrente, u mbush kupa

Kish në sallë dhe një nipçe
Vogëlush, që s'dinte ç'bëhej;
Qeshnin njerëzit edhe qanin
Kur thosh: «Gjyshi, do maltohej».

Ç'ESHTË IMPERIALIZMI?

Një kopësht zoologjik,
Me' tigra, bizónë, minj,
krokodilë, peshkaqenë, hipopotamë.
Ku egërsirat janë tërbuar
Dhe duhen rrëthuar,
Se duke u çarë vetë,
Rrezik të marrin më qafë
Dhe miljona jetë.

MISIONAREVE NË KOLONI

Eshtë e lashtë një fjalë e urtë:
«Kur gjen fshatin pa qen,
Mund të shkosh pa shkop në dorë,
Asnjë e keqe nuk të gjen»

Disa thonë proverb tjetër:
«Në luadh që është pa zot,
Kush të dojë shkon e shtrihet,
Kush të dojë vete kullot»



I pat thënë kto bota plakë,
Rendi i vjetër si qëmoti,
Por ja që, në këtë shekull,
Në çdo vënd ka dalë i zoti

Dhe kÿ zot tani urdhron:
— Nga ke ardhur e di vetë;
Prapa ktheu dhe merr vrapiñ,
Ndryshe kthen patkojt përpjetë!

GANGSTERİZƏM U.S.

— A ke ndonjë thikë
A vegël vrasëse çfarëdo?
— Jo, jo! Për Zotin, ju them të vërtetën!
— Atéherë, duart lart
Dorëzo shpejt kuletën!



RACIZËM

Hej, ti zezak, pse ke hyrë në këtë lokal?

Nuk sheh tabellën: «Ndalohet për njerëz me ngjyrë?»

«Oh më fal; qënka vetëm për kanibalë!

Pra, urdhëro atëherë «Hyrë...!»

ME POZITË E PA POZITË.

Dikur, shok, të përshëndeta
Edhe ti s'm'i ktheve sytë
Ku ta dinja unë i shkreti,
Që ishe ngritur në pozitë?

— Shoko, zbrit këtu në tokë!
Mos kaq lart, or derëzi,
Ule hundën pak më poshtë,
Se t'u bë mëndja veri.

Dhe shqiponja mbret i zogjve,
Fluturon gjer lart në re,
Porse kokën e m'ban ulur,
Dhe vështron gjithmonë pér dhe.

• • • • •
S'vate gjatë; dje u takuam,
Më përshndete si më parë,
Sot më thanë ke rënë nga shkallët...
Dhe ke marrë samarë zvarrë..!



GJYSHJA, MBRETI DHE PALLATET

Në përrallë gjyshja plakë,
Kur isha fëmi,
Më tregonte për pallate,
Mbretër e hyjni.

Dhe më zjente fantazia,
Përherë më shumë,
Hypja, zbrisja nér pallate,
Por vetém në gjumë..!

— Nëno, shih, — i thashë sot, —
Si po rriten katet,
Si n'përrallë kur më tregoje,
Varg janë pallatet!

— S'janë pallate — më tha plaka, —
Pallati nuk ka lezet.
T'hyjn' e t'dalin vegjëlia
E mos ketë vënd për mbret..!

— Nëno, hesht — i thashë — aman,
Se me mbretër e mbretri,
Pallat, vetëm se në ëndër,
Do shikonim unë e ti!

KUR TË VRET DHE DHIA SHYTE.

Tartabiqi milingonën
Një ditë shkoi për ta takuar
— Më vjen keq — i tha — dhe erdha
Të t'mësoj për të punuar.

Milingona qëndroi pak,
Dy antenat ia tundi
Dhe ashtu, siç qe ngarkuar,
Foli e qeshi sa mundi:

— Ti rron mbi kurriz të botës
Ç'mund të bësh a nuk më thua?
Kur për vehte s'je i zoti
Çfarë do t'më mësosh mua?

GRERA DHE BLETA.

— Ja dhe unë — thoshte grera
Bredh mbi lule e në fletë,
Thëthij lëng e mbledh polenë,
Pse mos më thërresin bletë?

— Përmbi lulet që thith unë,
Edhe ti mundet të shkosh,
— i tha bleta me të qeshur —
Po pse hojet i ke bosh?

Punë e mirë, o çamaroke,
D'o vullnet e do durim,
Po të bënje dhe ti mjaltë.
S'do lëpinje zgjoin tim!

KURSIMET E KOHA.

Disa çmojnë kursimet e të hollave,
Kur u janë mbaruar,
Të tjerë bëjnë kështu dhe me kohën,
Po kur ka kaluar.
Të parët, për nevojë mund të shesin
Ato që kanë blerë,
Por të dytët, s'mund ta gjejnë;
Koha iku, s'dëgjon të kthehet
E humbën për ngaherë.

PAK, POR SAK.

S'është nevoja të themi
Se dimë ngajeta,
Por ato që themi
Të jenë të vërteta.

Ç'ESHTË TRIMI?

Eshtë njeri si kushdo tjetër
Por që s'dridhet ndonjëherë,
E sheh vdekjen drejt në sy,
Edhe vdes vetëm një herë!

EDUKATE

— Ngreu, mor bir, — i foli plaku, —
Djalit të vogël gjithë zemrim —
Disa herë të kam thënë
Nëm pak ujë, bëj mundim.



— Hesht baba, — i tha më i madhi —
Ktij përtaci kot i thua,
Më mirë ngreu e pi vetë,
E, po deshe, nem dhe mua...

Babës, mjaf i jan' urimet,
Nëpër dasma e dolli
«Të rrojn' djemtë si azganë,
I ke shtyllë për pleqëri..!»

FSHATARI DHE QETË

Në një arë ugar të thatë
Po lëronte si ngaherë,
një fshatar me nj'ka të bëshëm
Dhe një dem të porsa mbrerë.

U lodh fort fshatari i gjorë
Kaut t'vogël thirrë e bot,
Herë poshtë e herë lart,
Në brazdë s'e vinte dot.

Dikush shkoi andej e tha:
— Nuk ka faj ky dem i ri,
Kau plak bën posht' përpjetë
Dhe tërheq tjetrin pas tij..!

Hapi krahun bujku shpejt,
Kaut plak, dy-tri hostenë,
Thelloi brazda ç'ke me të,
Pa të shoc, sa bukur venë..!

NJË ZBULIM NË ANATOMI!

E mërzit monotonia,
Gjith në zyrë e në shtëpi,
Shoku «Iks» vendos të dalë,
Një turne në miqësi.

Vecse duhet një raport,
Se pastaj hajd' e dëgjo:
S'ke ndërgjegje, disiplinë
E del ofsjat në bordero.

Por a ka sot gjë që s'bëhet?
Me përpjekje dhe mundim
(Doemos dhe zgjuarsia)
Për ta hedhur me mashtrim.

Shpejt mban vrapin n'ambulancë
Dhe te shkalla zë ec shtrembër,
Shtrëngon barkun nga 'e majta,
Se i dhëmbka zorrë e verbër!

— Doktor, kam apendicit
S'është akut për operim,

Vjen e shkon nganjëherë në vit...
Vetëm do ca dit pushim.



— Lojtke bukur si aktor,
Por — tha mjeku — mos harro,
Zorrë e verbër është m'të djathtë,
Ndrro shpejt dorën, mos gaboi!

E përçollti gjer te dera,
— Të lumtë — shtoi — diçka na çpike.
Po i shtohet një zbulim
Topografisë anatomike... !

PASQYRA E LËNDËS

| | Faqe |
|--------------------------------------|------|
| Me një shok të deleguar | 3 |
| Sa të vijë prap kontrolli | 5 |
| Punë e nxituar | 7 |
| Kontraste miqsh | 8 |
| Na del shkrim origjinal | 9 |
| I regjuri | 11 |
| Fjalë të mira e gur' në trastë | 13 |
| Në ambient | 15 |
| «Treshi» ka gjithë unitet | 17 |
| Kur vërshon zëri i masës | 18 |
| «Nxeħje sportive» | 19, |
| Paragjykim | 20 |
| Baba Qerimi ish zemëruar | 22 |
| Edhe zoti s'qe i zoti | 24 |
| Shkëndia e shenjtë | 26 |
| E kuptoi dhe tetu Mara | 28 |
| Nuk i mbetet kohë | 30 |
| Sikur t'ish rrufe nga retë | 32 |
| Dialog i shkurtuar | 34 |
| Eshtë puna ime | 35 |
| Q'faj i kemi? | 37 |
| Si cfingu | 38 |
| Kësaj radhe më s'i eci | 40 |
| Q'është imperializmi? | 42 |

| | |
|------------------------------|----|
| Misionarëve në koloni | 43 |
| Gangsterizëm U.S. | 45 |
| Racizëm | 46 |
| Me pozitë e pa pozitë | 47 |
| Gjyshja, mbreti dhe pallatet | 49 |
| Kur të vret dhe dhia shytë | 51 |
| Grera dhe bleta | 52 |
| Kursimet e koha | 53 |
| Pak por sak | 54 |
| C'është trimi? | 55 |
| Edukatë | 56 |
| Fshatari dhe qetë | 58 |
| Një zbulim në anatomi | 59 |

3444

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-85

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranië, 1963
Stabilimenti «8 NËNTORI»